

**“Shërbimit për klientë në
zbatim të Ligjit për faljen e
borxheve publike”**

Nr. 05 / L - 043



Para Juve!

• **Naim Mujaj**, ma.

Zyrtar për Plan të Biznesit & monitorim

KUR “Prishtina” sh.a.

Kronologjia e Ligjit për faljen e borxheve publike

- Më 05.02.2015 Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin nr.03/12 ka formuar Komisionin ekzekutiv për shqyrtimin e mundësisë së faljes së borxheve publike (9 anëtarë)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi në parim Projekt Ligjin mbi faljen e borxheve publike në seancën plenare të datës 09.07.2015 (vazhdimi me datën 10.07.2015)
- Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbledhjen plenare të datës 22.07.2015 Miratoi Ligjin ... nr. 05/L – 043
- Presidentja e Republikës së Kosovës me datën 07.08.2015 nr. DL-019-2015 dekretoi Ligjin...
- Ligji... me datën 18.08.2015 publikohet në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.
- Më 03.09.2015 fillon zbatimi i Ligjit...

Domosdoshmëria për Ligjin

- Pararendës i këtij Ligji... është Rregullorja për Rregullim dhe faljen e borxheve të vjetra nr. 06/ëë &ë e datës 26.01.2005. si dhe një numër lehtësirash tjera.
- Konsideroj se vendimi për sponsorizimin dhe miratimin e Ligjit është motivuar nga shkaqet: sociale (varfëria, ikja nga Kosova), politike (minoritetet), ekonomike, urbane etj.
- Kundërshtitë në lidhje me Ligjin janë shfaqur edhe në qarqet akademike, menaxhmentet e Ndërmarrjeve publike, përfaqësues të komunave, struktura të caktuara institucionale dhe politike etj, duke mos përjashtuar edhe atë pjesë e klientëve-taksapaguesve që përfitojnë dhe që nuk përfitojnë financiarisht nga zbatimi i Ligjit.
- Ligji ... ndihmon në spastrimin e bilanceve, veçanërisht te ndërmarrjet publike. Në fund të fundit nuk është se duhet besuar pa rezerva në bilancet e deklaruara, në të cilët ka plot llogari fiktive (faturimi aforfe, faturimi pa kryerje të shërbimit etj).

Ndërmarrjet Publike nuk kanë zbatuar dispozitat ligjore

- **Ligji mbi marrëdhëniet detyrimore i RSFJ-së i vitit 1978 (ligj i aplikueshëm) që ka qenë në fuqi deri më 31.12.2012 dhe Ligji për marrëdhëniet detyrimore miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nr. 04/L-077 borxhet ndaj ndërmarrjeve publike i klasifikon në dy grupe.**
- **-Personat fizik-parashkrimi dhe afati ligjor i pagesës është 12 muaj nga dita marrjes së shërbimit. Norma e kamat vonesës e përcaktuar në 3,5 %, duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës**
- **-Personat juridik- bizneset dhe institucionet -parashkrimi dhe afati ligjor i pagesës është 36 muaj nga dita marrjes së shërbimit. Norma e kamatë vonesës e përcaktuar në 3,5 %, duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës**

Përkufizimet e Ligjit...

- **1.1. Për qëllime të këtij Ligji “borxh publik” nënkupton çdo shumë të papaguar të borxhit, përfshirë ndëshkimet, gjobat, interesin si dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mospagesa , që kanë qenë obligim për pagesë i personave ndaj Institucioneve shtetërore, në emër të obligimeve tatimore, doganore dhe tatimit në pronë, si dhe të gjitha obligimeve tjera financiare ndaj Ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbime publike, në emër të shërbimeve të ofruara për qytetarët në Republikën e Kosovës deri më datën 31.12.2008 .**

Parimet mbi të cilat ndërtohet Ligji ...

- **Falja e kushtëzuar e borxheve publike**
- **Falja e kushtëzuar e gjobave, ndëshkimeve dhe interesave pas datës 01.01.2009**
- **Pagesa me këste e borxhit të falur në intervale të njëjta kohore**
- **Personat fizik 3 vite shtesë, të ndara në 18 këste të barabarta**
- **Personat juridik dhe institucionet, 2 vite shtesë të ndara në 12 këste të barabarta**
- **Fshirja automatike e borxhit deri në vlerën prej 100,00 €.**
- **Rikthimi i borxhit total në rast të dështimit në pagesë të dy e më shumë kësteve**

Çka është e rëndësishme?!

- Prej momentit të publikimit të idesë për Faljen e borxheve publike e deri ne hyrjen në fuqi ka kaluar një kohë shumë e gjatë.
- Shtatë muaj për “humbje kohë” për një ligj që ka vetëm 8 nene.
- Ndërmarrjet publike në tërësi gjatë vitit 2015 kanë pasur rënie në arkëtimin e faturave pikërisht për shkak të përfoljeve të Ligjit...
- Megjithatë, Ndërmarrjet publike nuk kanë bërë veprimet e domosdoshme me qëllim të përshpejtimit në fillim të zbatimit të ligjit; përgatitja e listave emërore, formimi i komisioneve, organizimi i fushatave promovuese, trajnimi i personelit, përpilimi i udhëzimeve të brendshme, determinimi për rastet specifike etj.

Vlera e borxheve potenciale që mund të falen sipas Ligjit

- Për shkak të neglizhencës dhe mospërgaditjeve të listave për borxhet potencialisht të falura vlerësohet se shuma e përafërt e borxhit është rreth 670.000.000 €.**
- Nga kjo shume vlerësohet se 465.000.000 € ose 69 % i takojnë ndërmarrjeve publike**
- 148.000.000 € përkatësisht 22 % janë borxhe të bizneseve ndaj Administratës Tatimore**
- 57.000.000 € përkatësisht 9 % janë borxhe ndaj Doganave të Kosovës**


Borxhet e ndërmarrjeve publike

- KEK, vlera e përafërt e borxheve potencialisht të falshme janë 346,30 milion € ose 52% e borxhit total përkatësisht 76 % e totalit të ndërmarrjeve publike.
- Ujësjiellësit kanë të deklaruar borxhe të periudhës rreth 48 milion €.
- Mbeturinat kanë deklaruar borxhe në vlerë prej afër 23,4 milion €.
- Ngrohtoret –nuk ka të dhëna
- Në total pjesëmarrja e amvisërive është diku rreth 82 %, bizneset e vogla 16 %, bizneset e mëdha dhe institucionet rreth 2 %

Ujësjetllësi “Prishtina” – 33.147.341

• N

Vlera në Euro



Borxhet 2009-2014

Nr	Viti	Faturimi vjetor	Arkëtimi vjetor (74,50%)	Borxhi i mbetur
1	2009	11,518,632	7,427,660	4,090,972
2	2010	12,405,344	8,647,105	3,758,239
3	2011	13,351,948	11,095,488	2,256,460
4	2012	14,862,236	10,850,710	4,011,526
5	2013	14,733,908	11,031,244	3,702,664
6	2014	14,097,852	11,244,019	2,853,833
T o t a l i		80,969,920	60,296,226	20,673,694

Paditë gjyqësore

- Ndërmarrjet publike për shkak të shkallës së ulët të arkëtimit të faturave dhe procedurave të komplikuar kanë dështuar në dërgimin në gjykatë të klientëve borxhlinj.
- Ujësjellësi Prishtina brenda muajit distribuohen mesatarisht 110.000 fatura, ndërsa nuk arkëtohen më shume se 25 deri 30.000 pagesa.
- Viti 2005 257 padi 158.859 €
- Viti 2008 308 padi 210.109 €
- Viti 2009 1.428 padi 261.447 €
- Viti 2010 2.438 padi 1.484.063 €
- Viti 2011 1.913padi 1.669.321 €
- Viti 2012 205 padi 243.400 €
- Viti 2013 257 padi 248.485 €
- Viti 2014 32 padi 45.445 €
- Total 6.819 padi 4.321.130 €

“Humbjet” vs përfitimet nga Implementimi i Ligjit...

- **Humbjet**-procesi tarifor në Republikën e Kosovës brenda një viti fiskal nuk njeh nocionin e humbjeve. Me tarifën aktuale si dhe me tarifat pararendëse është siguruar mbulimi i kostove operative dhe kostot e investimeve. Rregullatori ekonomik (ZRRUK-u), vazhdimisht ka marrë në konsideratë humbjet teknike e administrative të ujit nga njëra anë si dhe normën e caktuar të arkëtimit (e ulët) të faturave nga ana tjetër duke vënë përpara ndërmarrjeve përafrimin e objektivave optimale. Dështimi i “vazhdueshëm” në realizimin e objektivave ka rezultuar me mbingarkesë në të tarifës së shërbimit.

“Humbjet” vs përfitimet nga Implementimi i Ligjit...

- **Përfitimet** konsideroj se do të jenë të natyrës financiare dhe jofinanciare:
- Financiare- zbatimi i kushtëzuar i Ligjit do të ketë ndikim thelbësor për arkëtim të përshpejtuar të borxheve të papaguara për periudhën pas datës 31.12.2008. Kjo do të reflektojë me ngritjen e shkallës aktuale të arkëtimit mbi nivelin aktual maksimalisht deri në normën 100 % gjatë 3 viteve sa pritet të jetë efekti i Ligjit
- Jofinanciare, spastrimi i listave nga llogaritë e pambledhshme, korigjimi i bilanceve etj

Qasja për implementim të Ligjit ...

- Implementimi i Ligjit ..., njëkohësisht atakon të gjithë konsumatorët pa asnjë përjashtim;
- Së pari, impakt të drejtpërdrejtë te shumica e konsumatorëve që ndër vite kanë bërë pagesë të rregullt të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza e të cilët nuk përfitojnë asgjë nga Ligji.
- Së dyti, ndikimi i rëndësishëm për klientët që kanë borxhe të papaguara dhe përfitojnë nga dispozitat e Ligjit...
- Së treti, klientët e skemës sociale mund të qëndrojnë indiferent për shkak të pamundësisë së përfitimit nga implementimi i Ligjit... për shkak të faljes së kushtëzuar.

20,673,694

- Ana më e mirë e një “borxhi të keq” është arkëtimi në total mbase edhe i pjesshëm i tij. Sidomos atëherë kur janë ndërmarrë të gjitha masat e mundshme dhe nuk është arritur suksesi i pritshëm.
- Atëherë kur edhe rrugët ligjore janë shterur ose në raste të caktuara janë pamundura.
- Efekti pozitiv i pritshëm në këtë rast duhet të shpresohet te zbatimi konsekuent i Ligjit për faljen e borxheve publike

Fokusimi

- **Miratimi i një manuali të shkruar për procesin e zbatimit të Ligjit...**
- **Caktimi i një zyrtari kompetent (sipas nevojës më shumë) , i pajisur me vlera profesionale dhe morale,**
- **Krijimi i dosjeve të veçanta për çdo klient që aplikon për përfitimet sipas Ligjit ...**
- **Nxitja e klientëve që përfitojnë nga Ligji për pagesën e borxhit të prapambetur pas datës 31.12.2008 për pagesa të përnjëhershme ose në riprogramimin në periudha sa më të shkurtra kohore**
- **Krijimi i evidencave shtesë, të disponueshme për pjesën analitike dhe përmbaruese brenda ndërmarrjes,**
- **Organizimi i fushatave mediatike në interes të zbatimit të Ligjit...**

Fokusimi +

- **Fragmentarizmi i borxheve aktuale duke rritur interesimin në klientët që përfitojnë më së shumti nga Ligji ... dhe natyrisht sërish mbetën debitorët më të mëdhenj,**
- **Kombinimi i metodave që janë dëshmuar si frytdhënëse në arkëtimi: dërgimi në vazhdimësi i njoftimeve për konsumatorët që mund të përfitojnë nga falja e borxhit për periudhën para datës 31.12.2008 e që janë debitorë pas periudhës 01.01.2009.**
- **Shfrytëzimi i gjykatave dhe përmbaruesve për rastet e dështimit të marrëveshjes,**
- **Intensifikimi i dërgimit të njoftimeve të shkyçjes nga shërbimi (tarifa 3 €)**
- **Intensifikimi i procesit të shkyçjes nga rrjeti i furnizimit.**

Përfundimi

- Procesi tarifor për të gjitha vitet e kaluara ka siguruar një mbajtje të vazhdimësisë dhe konsistencës së veprimtarisë bazike për të cilat ekziston ndërmarrja publike.
- Prandaj...
- Ekzistimi i një gatishmërie të përgjithshme për krijimin e fondeve të veçanta investime nga paratë që do të arkëtohen nga zbatimi i Ligjit..., me qëllim të ngritjes thelbësore të nivelit të shërbimeve (sigurimi i sasive të reja të ujit, ujëmatës funksional, kamionë special, ekskavatorë etj).



• **F a l e m i n d e r i t !**